



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E  
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
GJUHË SHQIPE

**FORMULARI I IDENTIFIKIMIT**

---

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

**NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT**

--	--	--	--	--	--	--	--


SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_

---

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Në këtë faqe mund t'i qasesh rezultateve <http://zios.mpn.gov.rs/>  
Përdoruesi: shkruaj numrin tënd të identifikimit  
Fajlëkalimi: 00c1e6d4c254

## UDHUZIME PËR PUNË

- Testi ka 20 detyra, të cilat duhet t'i zgjidhni për **120 minuta**.
- Shkruaj lexueshëm, me shkronja shqipe, duke pasur kujdes që përgjigjet tuaja të jenë të kuptueshme, por të jenë në rregull edhe sipas rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore.
- Kur zgjidh detyrat në të cilat nga ti pritet të shkruash diçka, shkruaj gjithmonë emërtimet e plota, sepse shkurtesat nuk janë të lejuara (p.sh. duhet të shkruhet *emri*, e jo *em.* ose *rrjedhore*, e jo *rrje.* dhe ngjashëm).
- Testin plotësoje me **laps me ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë).
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps shkruaj – fshij nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me përgjigje të ofruara, nuk do të jenë të pranuar, nëse përgjigjet janë të përmirësuar.
- Mos shkruaj asgjë në QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.
- Bëj kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.

Tek disa detyra zgjedh përgjigjet e sakta ashtu që do të ngjyrosësh rrethin para përgjigjes së saktë. Tek detyrat tek të cilat ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosësh më tepër rrethë. Bëj kujdes që rrethi të ngjyroset patjetër, sepse vetëm ashtu përgjigja do të jetë e pranueshme.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse përfundon më herët, dorëzo testin dhe largohu ngadalë në qetësi.

Të dëshirojmë shumë sukses në provim!



## PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
GJUHË SHQIPE

## 1. Lexo:

Dy prej luanëve kishin rreth e përçark qafës, gjer përposh në gushë, jele të dendura dhe shumë të bukura. Ishin meshkuj. Trupin e kishin të lidhur e gjithë muskuj, si të qenë skalitur në gur. Femrat e kishin trupin pak më të ulët, më të zgjatur dhe më të zhdërvjellët. Që të pestë kishin sy të verdhë, të hapur, jashtë mase, të aftë për të parë përpara një pikë të caktuar, si sytë e njeriut. Egërsirat shikonin se si të largoheshin prej tyre, kopetë e kafshëve barngrënëse. Luanët qëndronin në një vend paksa të ngritur, buzë lumit dhe herë pas here ulërinin me një zë të zgjatur dhe të ngjirur.

Ndzyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Teksti i dhënë është:

- Informim;
- Përshkrim;
- Kritikë.

## 2. Në cilin tekst autori përshkruan përshtypjet, përjetimet, zbulimet, aventurat etj.

Ndzyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Tek lajmi;
- Tek intervista;
- Tek udhëpërshkrimi;
- Tek novela.





### 3. Lexo vargjet

Trim mbi trima Gjergj Elez Alija!  
Qe nandë vjet, nandë varra n'shtat m'i ka  
veç ni motër, nat e ditë te kryet  
ia lan varrat me ujt t'gurrës nandvjeçe  
ia lan varrat me ata lot e syve,  
ia ter gjakun me ato flokët e ballit  
shtatin vllaut ia shtrëngon m'rub t'nanës  
n'petka t'babës trupin ia hijeshon  
armët e brezit ia rendon mbi krye.

Përgjigju pyetjeve të dhëna:

1. Si quhet trimi? \_\_\_\_\_
2. Sa vjet vuan trimi? \_\_\_\_\_
3. Sa plagë i kishte në shtat? \_\_\_\_\_
4. Sa motra i rrinin pranë? \_\_\_\_\_
5. Me se ia lante varrat? \_\_\_\_\_
6. Me se ia terte gjakun? \_\_\_\_\_
7. Me se ia hijeshonte trupin? \_\_\_\_\_
8. Çka i rëndon mbi kokë? \_\_\_\_\_

### 4. Lexo pyetjet

Cili tekst fillon:

1. U linda më 12.11.1987 ...
2. U lind më 19.09.1993...

Shkruaj përgjigjen në vijën e zbrazët

1. Bëhet fjalë për tekstin \_\_\_\_\_
2. Bëhet fjalë për tekstin \_\_\_\_\_





5. Plotëso tabelën me të dhënat personale, të cilat zakonisht kërkohen kur plotësohet një CV:

<b>INFORMATAT PERSONALE:</b>	
Emri dhe Mbiemri	
Numri personal i ID	
Adresa:	
Telefoni	
Email:	
Nacionaliteti:	
Data dhe vendi i lindjes:	

6. Lajmi është dhënë në mënyrë të çrregulluar. Formo lajmin duke i përgjigjur pesë pyetjeve të lajmit (kush?, kur?, ku?, çka?, si?, ose pse?.)

Mbajtën tubim para qytetarëve, dy kryetarët e komunave, sot, Preshevë e Bujanoc, ata folën rreth, në sallën e Shtëpisë së Kulturës „Abdulla Krashnica” në Preshevë, kulturës dhe arsimit në gjuhën shqipe.

---



---



---



---

7. Nga grupi i bashkëtingëlloreve të dhëna gjej dhe shkruaj bashkëtingëlloret mesgjuhore:

K, Q, SH, GJ, J, H, NJ,

\_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

8. Përcakto përemrat pronorë, vetorë, dëftor, pyetës:

1. ime, jote, e mi, tuaj, janë \_\_\_\_\_
2. kush, cili, sa, çfarë, janë \_\_\_\_\_
3. ky, këtë, kjo, i tillë, janë \_\_\_\_\_
4. unë, ti, ai, ajo, ne, janë \_\_\_\_\_





**9.** Cili është libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe?

Ndijros rrethin para përgjigjes së saktë.

- „Meshari” nga Gjon Buzuku;
- „Çeta e profetëve” nga Pjetër Bogdani;
- „E mbësuarë e krishterë” nga Lekë Matrënga.

**10.** A janë fjalë të përngjitura fjalët:

Shëno me X përgjigjet e sakta

- 1. Zemërgjerë            PO / JO
- 2. Asnjëherë            PO / JO
- 3. Gjithmonë            PO / JO
- 4. Frymëmarrje        PO / JO
- 5. Njëmbëdhjetë      PO / JO
- 6. Tungjatjeta         PO / JO

**11.** Trego çka quajmë theks të fjalës?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Mënyrën se si mund ta shqiptojmë fjalinë.
- Dallimi me zë i njërës prej rrokjeve të një fjalë.
- Kur folësi dëshiron ta dalloj fjalën nga të tjerat.

**12.** Shkruani emrat e dhënë në numrin shumës:

- Libër, flutur, kopsht, pallat, xhep, bari, lumë, akull, plak, mbret, mik, dorë.





**13.** Lexo fjalitë e dhëna.

Dallo llojet e lidhëzave të nënvizuara dhe shkruaji në vijëzat në fund të fjalive.

a) Ketri jeton në pyje dhe ushqehet me lajthi.

\_\_\_\_\_

b) Ketri përdor bishtin kur hipën në pemë.

\_\_\_\_\_

**14.** Fjalët e mëposhtme që janë shkruar në gjuhën e folur lokale, shkruani sipas rregullave të gjuhës letrare.

támël \_\_\_\_\_; xham \_\_\_\_\_; kërrpë \_\_\_\_\_; shtrafciger\* \_\_\_\_\_; patika \_\_\_\_\_;

lluster \_\_\_\_\_;

Trego klasën gramatikore të cilës i përkasin: \_\_\_\_\_.

**15.** Trego me cilin lloj të vargut shkroi poezinë „Anës lumenjve “ Fan S. Noli:

Ky ilaç e ky kushtrim më bën djalë e më bën trim,  
me jep forc'ë më jep shpresë anës Elbës, anës Spresë.  
Se pas dimrit vjen një verë që do kthehem njëherë,  
pranë vatrës, pranë punës anës Vjosës, anës Bunës.

Rretho përgjigjen e saktë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Katërrokësh;
- gjashtërokësh;
- tetërrokësh.





16. Lexo tekstin dhe shkruaj emërtimin e formës përkatëse të rrëfimit: (monolog, dialog, tregimin, përshkrim):

- E, Mark, qenke lagur shume! Pastaj zbathur në këtë kohë të keqe? – i fola ëmbël. Vetëm më shikoi pa më thënë fjalë. Më ngjau sikur mendonnte me vetvetën.
- A ke turp të më përgjigjesh, Mark? – e nxita për së dyti duke i ledhatuar flokët, që i vareshin mbi ballë si tufë mëndafshi.
- Jam nisur herët, zotëri, por binte shumë shi dhe mezi kalohej nga lluca dhe nga ujërat! - mu përgjigj.
- Lluca dhe ujëra! – pëshpëriti edhe një shok i tij.
- A e ke larg shtëpinë, Mark\_
- Besa larg, mjaft larg! Ja, andej, matanë atyre kodrave!
- Sa kohë e bën rrugën gjer në shkollë?
- Si të jetë koha zotëri: kur është koha e mirë, e bëj edhe për dy orë, por si sot, besa edhe për tri mezi që kam ardhur!
- Aq larg e paske shtëpinë, Mark?
- Po, zotëri, shtëpinë e kam shumë larg.
- Po këtë shami me se e ke?
- Këtu e kam drekën, zotëri – tha dhe uli sytë.

Forma e rrëfimit është \_\_\_\_\_.

17. Lexo vargjet e kësaj poezie dhe trego cilit lloj të poezisë i përket.

Të falem ty..

Të falem ty o gjuhë – shkëmb  
me rrënjët thellë në shkëmbenj  
që çave qiellin kur t’u vrenj  
dhe shembe bisha shtërpënj  
po mbete prapë  
shkrep e shteng

Mitrush Kuteli

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Kjo poezi është:

- Poezi lirike;
- Poezi epike;
- Poezi poetike.





**18.** Lexo tekstet dhe trego gjininë letrare të tyre.

- a) Zoti të bekoftë, mor djalë, - u përgjigj babai. Dhe meqë anija do të nisej atë ditë, e mori djalin me vete. Një ditë e shkëlqyer me diell deti ishte vaj. Stefani i cili nuk kishte udhëtuar kurrë në det, endej i humbur...
- b) Atë lis të rrahur nga erërat e kam pasur mësuesin e parë në jetë dhe mësimi i parë që më ka dhënë ka qenë: Qëndresa.
- c) TURSUN BEU: - Me ju nuk kam ç'të flas më. Tash e tutje do flasë me ju vetëm ligji. Uluni!  
 ABDYLI: - Nëse e keni.  
 TURSUN BEU: (Gërthet.) Uluni! (Në sallë mbretëron qetësia.)  
 TURSUN BEU: - Sulejman Vokshi, ngrihuni!

a) Teksti i përket gjinisë \_\_\_\_\_;

b) Teksti i përket gjinisë \_\_\_\_\_;

c) Teksti i përket gjinisë \_\_\_\_\_.

**19.** Lexo tekstet e poshtëshënuar dhe trego cili është biografi dhe cili është autobiografi:

a) Dora d'Istria, me emrin e vërtetë Elena Gjika, lindi në Rumani në vitin 1828 dhe vdiq në Firence të Italisë, në vitin 1888. Ajo i përkiste familjes shqiptare Gjika, që u largua nga Shqipëria në shek. XVII dhe u vendos në Rumani. Dora d'Istria njihete shkëlqyer 9 gjuhë, të cilat i fliste dhe i shkruante me elegancë të madhe. Shumë shpejt u bë një nga intelektualet evropiane më në zë të epokës së vet.

b) Linda më 10 prill të vitit 1856 në fshatin Smiljan të Kroacisë. Ishte një natë me stuhi, bubullima, dhe rrufe. Më kanë thënë se dikush nga familjarët e frikësuar, kishte thënë: „Do të jetë fëmijë i stuhive”. Mamaja ime ia kishte kthyer: „Jo i stuhive, por i dritës”. Më kujtohet se një mbrëmje, si fëmijë, po luaja me maçokun e zi që ishte dobësia ime më e madhe. Kur po e lëmuaka maçokun në shpinë, ndodhi çudia më e madhe, që më la pa fjalë.

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_





## 20. Vaje

Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam parë  
Lotët që kam derdhur, s'më janë tharë  
Shumë vjetë u bënë sot u mbushën dhjetë  
Që kur më ke lënë dhe stë shoh në jetë.

Andon Zako Çajupi

Poezia nga e cila janë shkëputur këto vargje i përket llojit të poezisë:

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- baladë;
- himnit;
- elegjisë.



# FAQE E ZBRAZËT



00c1e6d4-c254-4728-9983-4d34ea56e614

**ИНТЕРНО**

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë  
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E  
 ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
 ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
 ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
**GJUHË SHQIPE**

**FORMULARI I IDENTIFIKIMIT**

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

Në fushat e zbrazëta shkruaj numrin tënd të identifikimit (nga një shifër në çdo fushë), kurse në vazhdim, poshtë çdo shifre ngjyros rrethin përkatës. P.sh. në fushën me numrin e identifikimit të nxënësit nën numrin 3 ngjyros rrethin pranë numrit 3.

**NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT**

<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0	0	0	0	0
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
1	1	1	1	1	1	1	1
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2	2	2	2	2	2	2	2
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3	3	3	3	3	3	3	3
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4	4	4	4	4	4	4	4
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
5	5	5	5	5	5	5	5
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6	6	6	6	6	6	6	6
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7	7	7	7	7	7	7	7
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8	8	8	8	8	8	8	8
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
9	9	9	9	9	9	9	9

**SHEMULL I NUMRIT TË PLOTËSUAR TË IDENTIFIKIMIT**

1	0	0	1	9	9	0	7
<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
 VENDI \_\_\_\_\_  
 KOMUNA \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

